

VIRUSI TRANSPARENTITIS

MONITORIMI I PROKURIMIT
PUBLIK NË MINISTRINË
E SHËNDETËSISË

MARS 2016



**MONITORIMI I
PROKURIMIT PUBLIK
NË MINISTRINË E
SHËNDETËSISË**

COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
HYRJE.....	10
SHPENZIMET SHËNDETËSORE PËR KOKË BANORI.....	11
METODOLOGJIA.....	15
TRANSPARENCA.....	16
ANALIZA E KONTRATËS.....	17
FURNIZIMI ME CITOSTATIK.....	18
VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI.....	18
PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT.....	18
VLERËSIMI I OFERTAVE.....	19
ANKESAT NË OSHP.....	20
FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES.....	21
VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI.....	21
PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT.....	22
VLERËSIMI I OFERTAVE.....	24
ANKESAT NË OSHP.....	26
FURNIZIMI ME BARNÄ ANTI-VIRALE (ANTI-INFJEKTIVË).....	28
VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI.....	28
PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT.....	29
VLERËSIMI I OFERTAVE.....	29
ANKESAT NË OSHP.....	29
ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE.....	29
REKOMANDIME.....	30

LISTA E SHKURTESAVE

AFSh	→ Agjencia e Financimit Shëndetësor
AK	→ Autoriteti Kontraktues
AKPM	→ Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
AQP	→ Agjencia Qendrore e Prokurimit
ASK	→ Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARBK	→ Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
CE	→ Conformité Européenne
BE	→ Bashkimi European
DT	→ Dosja e Tenderit
GK	→ Grupi Punues
ISO	→ Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
KDI	→ Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	→ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LEB	→ Lista Esenciale e Barnave
LPP	→ Ligji për Prokurimin Publik
MSh	→ Ministria e Shëndetësisë
MTI	→ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OBSH	→ Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	→ Operatori Ekonomik
OSHP	→ Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKUK	→ Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SHSKUK	→ Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
TAPP	→ Transparenca dhe Llogaridhënia në Prokurimin Publik
TI	→ Transparency International
UA	→ Udhëzim Administrativ
ZP	→ Zyrtar i Prokurimit
ZAP	→ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mosofrimi i shërbimeve cilësore nga institucionet publike shëndetësore vazhdon të mbetet peng i buxhetit të ulët, i cili nuk i mbulon as nevojat minimale të rreth 1.8 milionë qytetarëve kosovarë. Kosova shpenzon pesë herë më pak se Shqipëria në shëndetësinë publike, shtatë herë më pak se Maqedonia, dhe nëntë herë më pak se Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqia. Kur këtij problemi i shtohen edhe keqplanifikimet dhe keqmenaxhimet e kontratave, atëherë kjo bëhet edhe më e pa përballueshme për pacientët, të cilët janë të detyruar që koston e shërimit ta bartin vetë nga të ardhurat e tyre, edhe ashtu minimale.

Ky raport ka pasur synim që të tregojë transparencën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të gjejë dobësitë në sistemin e prokurimit në këtë institucion, me qëllim të përmirësimit të gjendjes. Kjo është bërë duke matur zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, përmes ekzaminimit të kontratave të Ministrisë së Shëndetësisë për furnizime me citostatikë, material shpenzues dhe anti-infektiv, të cilat janë analizuar në faza të ndryshme. Në total janë analizuar nëntë produkte medicinale të blera përmes gjashtë kontratave që kanë spektër të gjerë të çmimeve dhe përdorimit, për të fituar një pasqyrë më të mirë të sistemit të prokurimit në këtë institucion.

Deri në vitin 2013, MSH kishte realizuar prokurime të centralizuara që kishin rritur koston e shpenzimeve, dhe kishte blerë shumë barna që nuk ishin esenciale për shëndetin e pacientit. Në vitin 2013 ishte përpiluar Lista Esenciale e Barnave, dhe nga viti 2014 MSH realizon blerjet për qendrat e mjekësisë familjare, dhe

artikujt e prokuruar liferohen në qendrat përkatëse nga Operatorët Ekonomik. Agjencia e Financimit Shëndetësor bën konsolidimin e nevojave të paralogaritura nga institucionet spitalore, dhe atyre të kujdesit primar, të cilat procesohen përmes divizionit farmaceutik të MSH. Para procesimit të kërkesave tek Divizioni i Prokurimit, një nga rolet e AFSh është të verifikoj validitetin e kërkesës, të sigurohet që barnat e kërkuara janë në LEB, dhe dispozicionin e mjeteve financiare.

E vlen të theksohet se LEB nuk ka ndryshuar, apo është rifreskuar që nga viti 2013.



Sipas Cobus de Swardt, Drejtor Menaxhues i Transparency International: “Kur produktet që, në fund të fundit qytetarët paguajnë për to, janë të rrezikshme, të papërshtatshme apo të kushtueshme do të jetë një humbje e pashmangshme e besimit të publikut në qeveri”.

Analiza që keni në duar e shpërfaqë mungesën e transparencës së këtij institucioni si një nga problemet kyçe. Deficienat në transparencë Ministria në fjalë i arsyeton me mungesën e kohës dhe kapaciteteve. Transparenca është një mekanizëm i shfaqjes së integritetit institucional dhe profesional, dhe përkufizohet si qasje në informata në kohën e duhur, që është lehtë-

sisht e kuptueshme, dhe mbron integritetin e procesit dhe interesat e të gjithë akterëve të përfshirë.

Gjetjet e këtij raporti për blerjen e citostatikëve tregojnë që buxheti i kufizuar në kombinim me përzgjedhjen e ilaçeve me kosto shumë të lartë rezultojnë me përbushje të kufizuar të nevojave vetëm deri në 40%. Kjo tregon që ka hapësirë të madhe për përmirësim të planifikimit të blerjes së ilaçeve.

Blerja e materialeve shpenzuese si gazat sterile, dorëza apo mantelet është përcjellë me pretendime të shumta për parregullsi. Cilësia e dobët e këtyre materialeve është rezultat i mos azhurnimit të Listës Esen-



cialë të Barnave, e cila Listë nuk i specifikon kërkesat për kualitet. Kjo rezulton në blerjen e produkteve me kualitet të dobët.

KDI ka analizuar edhe kontratën për furnizim me bar-na anti-virale. Qasja në informata mbi blerjen e barit Peginterferon nuk është ofruar nga ana e Ministrisë pavarësisht kërkesës së KDI-së të bërë në gusht 2015. Kurse gjetjet për blerjen e ilaçit Ribavirin, në të cilin është lejuar qasja, tregojnë për një proces prokurimi që është zhvilluar brenda kornizave ligjore.

Nga analiza e këtij raporti, për pjesën në të cilën është lejuar qasje, vijnë në konkludim se brengat kryesore lidhur me prokurimin brenda MSH kanë të bëjnë me çmimin tejet të lartë të produkteve, krahas buxhetit të kësaj ministrie. Kjo rezulton me mos plotësim të nevojave. Mos azhurnimi i Listës Esenciale të Barnave shkakton probleme zingjirore në prokurimin e këtyre barnave, ndër tjera ofron cilësi të dobët të materialeve shpenzuese.

Por, efekti kryesor bartet tek vetë qytetari i Kosovës. Sipas Bankës Botërore, qytetarët e Kosovës mesatarisht kanë pesë vite më pak jetëgjatësi se qytetarët e vendeve të rajonit, dhe 10 vite më pak se qytetarët e BE-së për si pasojë e sektorit të dobët të shëndetësisë.

Për të përmirësuar këtë situatë KDI ka ofruar edhe një numër të rekomandimeve, që kanë të bëjnë me adresimin e këtyre nevojave imediate si rifreskimi i Listës Esenciale të Barnave, përmirësimi i planifikimit të prokurimit, krijimi i një sistemi elektronik të regjistrimit dhe evidencës së pacientëve dhe evidentimit të konsumit; analizimi i produkteve nën patentë dhe aplikimi i procedurave të negocimit për blerjen e tyre; si dhe nevoja për analizë të tregut për të pasur pasqyrim të përafërt lidhur me ofertën që mund të kenë kompanitë për produkte të caktuara dhe për t'u mbrojtur nga fiksimi i çmimeve.





HYRJE

Sipas raporteve të publikuara prej autoriteteve qeveritare për vitin 2014¹, nga gjithsej 1,589 Milion Euro² të Buxhetit të përgjithshëm qeveritar, 445.2 Milion Euro³ janë shpenzuar përmes procedurave të prokurimit. Kjo vlerë paraqet 28% të vlerës së përgjithshme të buxhetit. Shpenzimet e fondeve publike përmes prokurimit publik në Kosovë janë në masë të madhe të mbyllura për publikun dhe si rezultat nuk ka qasje dhe mbikëqyrje të duhur nga shoqëria civile, media dhe vetë publiku, dhe si të tilla paraqesin një potencial serioz për keqmenaxhime. Analizimi i proceseve tenderuese dhe i zbatimit të legjislacionit, (që rregullon fushën e prokurimit publik, duke vënë në pah parregullsitë dhe avokimin për marrjen e masave ndaj keqpërdoruesve) konsiderohet si një prej elementeve kryesorë, që do të ndikonin në ndërtimin e një ambienti më konkurrues, ku bizneset ndihen të lira dhe të barabarta në treg.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në kuadër të Programit të Transparencës dhe Kundër korrupsionit, respektivisht monitorimin e Prokurimit Publik, ka hulumtuar dhe publikuar shumë raporte mbi procedurat e përpilimit të specifikave teknike, procesit të tenderimit dhe vlerësimit të ofertave, dhënies së kontratave, menaxhimit të kontratave, ankesave dhe vendimeve të OSHP, të gjeturat në faza të ndryshme të prokurimit publik.

1 Për krahasim janë marr publikimet e vitit 2014, meqë publikimet për vitin 2015 janë edhe në përpunim nga Institucionet përkatëse

2 <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

3 <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20Vjetore/2014/Raporti%20Vjetor%202014%20Shqip%20KRPP.pdf>

Prokurimi Publik në Kosovë ballafaqohet me probleme nga më të ndryshmet si dispozitat ligjore të pamjaftueshme, mungesa e trajnimeve adekuatë, planifikimet e dobëta, mungesa e vullnetit të mirë dhe

integritetit, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, etj. dhe konsiderohet si sektori më i korruptuar dhe keqmenaxhuar brenda Institucioneve Publike të Kosovës⁴.

Në këtë vazhde të zhvillimeve, prokurimi brenda Ministrisë së Shëndetësisë vazhdon të mbetet si një nga më të përfolurat në mediat vendore si për keqplanifikime, po ashtu edhe për keqmenaxhim dhe kurdisje të tenderëve.

Qëllimi i këtij raporti është që të analizoj procedurat e tenderimit

dhe dhënies së kontratave për artikuj furnizues në tri reparte të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Onkologjisë për furnizimet me Citostatik, Material Shpenzues për nevojat e QKUK, dhe furnizimet me barna antivirale për Klinikën Infektive.



Për përpilimin e këtij raporti, KDI ka analizuar mbi 730 dokumente dhe publikime, me mbi 12,000 faqe, ka pasur dhjetra takime dhe biseda telefonike, dhjetra komunikime përmes postës elektronike, ka parashtruar 9 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, etj.

4 BE: Raporti i Progresit 2015 Kosovo*, 10/11/2015 Bruksel



SHPENZIMET SHËNDETËSORE PËR KOKË BANORI

Një nga brengat kryesore të shoqërisë, por edhe ofruesve të shërbimeve dhe furnitorëve⁵ mbetet buxheti i ulët i alokuar për shpenzimet mjekësore për kokë banori në Kosovë. Gjatë analizimit të buxhetit të Kosovës për vitet 2013⁶, 2014⁷ dhe 2015⁸, shohim se nga vlerat e Mallrave dhe Shërbimeve dhe Shpenzimeve Kapitale të nivelit qendror për këto tri vite, vetëm 6% ishin realizuar

nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas MSH, kostoja e shpenzimeve për kokë banori e Kosovës për vitin 2015 ishte 110.00 USD, që është më e ulëta në rajon, ku pas kësaj vlere, ajo më e ulëta në rajon për vitin 2013 është ajo e Shqipërisë në vlerë 539.00⁹ USD, që do të thotë se Kosova shpenzon 5 herë më pak se Shqipëria në shëndetësinë publike, 7 herë më pak se Maqedonia, dhe 9 herë më pak se Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqia.

5 Sipas intervistave individuale dhe grupit punues të organizuar nga KDI me datën 30 Nëntor 2015.

6 <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

7 <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

8 <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

9 WHO: World Health Statistics 2015 (http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/170250/1/9789240694439_eng.pdf?ua=1&ua=1)

10 <http://apps.who.int/gho/data/node.main.78?lang=en>

TAB. 1 – SHPENZIMET SHËNDETËSORE PËR KOKË BANORI PËR VITIN SIPAS OBSH¹⁰

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)	#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
1	Afganistan	\$161.00	7	Argjentina	\$1,725.00
2	Shqipëria	\$539.00	8	Armenia	\$351.00
3	Algjeria	\$778.00	9	Australia	\$4,191.00
4	Andorra	\$3,338.00	10	Austria	\$4,885.00
5	Angola	\$355.00	11	Azerbaigjan	\$957.00
6	Antigua dhe Barbuda	\$1,021.00	12	Bahamas	\$1,688.00

|||||

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
13	Bahrain	\$1,900.00
14	Bangladesh	\$95.00
15	Barbados	\$1,060.00
16	Belarus	\$1,081.00
17	Belgjika	\$4,526.00
18	Belize	\$458.00
19	Benin	\$82.00
20	Butan	\$275.00
21	Bolivia	\$372.00
22	Bosnia dhe Herzegovina	\$928.00
23	Botsuana	\$851.00
24	Brazil	\$1,454.00
25	Brunei Darussalam	\$1,812.00
26	Bulgaria	\$1,213.00
27	Burkina Faso	\$109.00
28	Burundi	\$62.00
29	Kote d'Ivoire	\$172.00
30	Kabo Verde	\$279.00
31	Kamboxia	\$229.00
32	Kamerun	\$138.00
33	Kanada	\$4,759.00
34	Republika Qendrore Afrikane	\$24.00
35	Çad	\$74.00
36	Kile	\$1,678.00
37	Kina	\$646.00
38	Kolumbia	\$843.00
39	Komoros	\$90.00
40	Kongo	\$242.00
41	Ishujt Kuk	\$513.00
42	Kosta Rica	\$1,369.00
43	Kroatia	\$1,517.00

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
44	Kuba	\$1,828.00
45	Qipro	\$2,197.00
46	Republika Çeke	\$1,982.00
47	Republika Demokratike e Kongos	\$26.00
48	Danimarka	\$4,552.00
49	Gjibouti	\$247.00
50	Dominica	\$597.00
51	Republika Domenikane	\$631.00
52	Ekuador	\$789.00
53	Egjipt	\$539.00
54	El Salvador	\$539.00
55	Guinea Ekuadoriale	\$1,170.00
56	Eritrea	\$36.00
57	Estonia	\$1,453.00
58	Etiopia	\$69.00
59	Fixhi	\$328.00
60	Finlanda	\$3,604.00
61	Franca	\$4,334.00
62	Gabon	\$735.00
63	Gambia	\$99.00
64	Gjorgjia	\$697.00
65	Germania	\$4,812.00
66	Gana	\$214.00
67	Greqia	\$2,513.00
68	Grenada	\$729.00
69	Guatemala	\$467.00
70	Guinea	\$59.00
71	Guinea-Bissau	\$79.00
72	Guyana	\$426.00
73	Haiti	\$160.00
74	Honduras	\$400.00

|||||

|||||

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
75	Hungaria	\$1,839.00
76	Islanda	\$3,646.00
77	India	\$215.00
78	Indonesia	\$293.00
79	Iran	\$1,414.00
80	Irak	\$695.00
81	Irlanda	\$3,867.00
82	Izrael	\$2,355.00
83	Italia	\$3,126.00
84	Xhamaica	\$512.00
85	Japonia	\$3,741.00
86	Jordan	\$761.00
87	Kazakistan	\$1,023.00
88	Kenia	\$101.00
89	Kiribati	\$187.00
90	Kuvait	\$2,375.00
91	Kyrgystan	\$221.00
92	Lao People's Democratic Republic	\$95.00
93	Latvia	\$1,310.00
94	Lebanon	\$1,092.00
95	Lesotho	\$297.00
96	Liberia	\$88.00
97	Libia	\$764.00
98	Lituania	\$1,579.00
99	Luksemburg	\$6,518.00
100	Madagascar	\$58.00
101	Malau	\$90.00
102	Maleisia	\$938.00
103	Maldives	\$1,260.00
104	Mali	\$122.00
105	Malta	\$2,652.00

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
106	Marshall Islands	\$703.00
107	Mauritania	N/A
108	Mauritius	\$864.00
109	Meksika	\$1,061.00
110	Mikronesia	\$448.00
111	Monako	\$6,123.00
112	Mongolia	\$567.00
113	Mali i Zi	\$926.00
114	Maroko	\$438.00
115	Mozambik	\$71.00
116	Mianmar	\$37.00
117	Namibia	\$749.00
118	Nauru	\$644.00
119	Nepal	\$135.00
120	Holanda	\$5,601.00
121	Zelanda e Re	\$3,405.00
122	Nikaragua	\$382.00
123	Niger	\$60.00
124	Nigeria	\$206.60
125	Niue	\$959.00
126	Norvegjia	\$6,308.00
127	Oman	\$796.00
128	Pakistan	\$126.00
129	Palau	\$1,288.00
130	Panama	\$796.00
131	Papua Guinea e Re	\$114.00
132	Paraguai	\$724.00
133	Peru	\$626.00
134	Filipine	\$287.00
135	Polonia	\$1,551.00
136	Portugalia	\$2,508.00
137	Katar	\$2,882.00

|||||

|||||

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
138	Republika e Koresë	\$2,398.00
139	Moldavia	\$553.00
140	Rumania	\$988.00
141	Federata Ruse	\$1,587.00
142	Ruanda	\$162.00
143	Saint Kitts dhe Nevis	\$1,332.00
144	Shën Lucia	\$898.00
145	Shën Vincent dhe Grenadines	\$555.00
146	Samoa	\$379.00
147	San Marino	\$3,709.00
148	Sao Tome and Principe	\$203.00
149	Arabia Saudite	\$1,681.00
150	Senegali	\$96.00
151	Serbia	\$987.00
152	Seychelles	\$937.00
153	Sierra Leone	\$228.00
154	Singapori	\$3,578.00
155	Slovakia	\$2,147.00
156	Slovenia	\$2,595.00
157	Ishujt Solomon	\$106.00
158	Afrika Jugore	\$1,121.00
159	Sudani Jugor	\$52.00
160	Spanja	\$2,846.00
161	Sri Lanka	\$304.00
162	Sudan	\$221.00
163	Suriname	\$744.00
164	Swaziland	\$564.00
165	Suedia	\$4,244.00
166	Zvicra	\$6,187.00
167	Siria	\$169.00
168	Taxhikistan	\$170.00

#	Vendi	Shpenzimi në shëndetësi për kokë banori (PPP int. \$)
169	Tailanda	\$658.00
170	Maqedonia	\$759.00
171	Timor-Leste	\$96.00
172	Togo	\$119.00
173	Tonga	\$250.00
174	Trinidad dhe Tobago	\$1,663.00
175	Tunisia	\$791.00
176	Turqia	\$1,053.00
177	Turkmenistan	\$276.00
178	Tuvalu	\$663.00
179	Uganda	\$146.00
180	Ukraina	\$687.00
181	Emiratet e Bashkuara Arabe	\$2,233.00
182	Mbretëria e Bashkuar	\$3,311.00
183	Republika e Bashkuar e Tanzanisë	\$126.00
184	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	\$9,146.00
185	Uruguaj	\$1,715.00
186	Uzbekistan	\$330.00
187	Vanuatu	\$115.00
188	Venezuela	\$656.00
189	Viet Nam	\$308.00
190	Jemen	\$200.00
191	Zambia	\$192.00
192	Mesatarja Botërore	\$1,240.86

|||||

METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit në këtë raport tenton të matë zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, përmes ekzaminimit të kontratave të Ministrisë së Shëndetësisë për furnizime me citostatik, material shpenzues dhe anti-infektiv, të cilat janë analizuar në fazë të ndryshme.

Për shkak të natyrës së kontratave të përzgjedhura, analiza trajton pesë (5) faza të prokurimit: vlerësimin e nevojave dhe planifikimit, përgatitjen e specifikacioneve teknike, vlerësimin e ofertave, zbatimin e kontratës dhe monitorimin e performancës, dhe fazën e auditimit dhe përmbylljes. Përpos tyre, kjo metodologji trajton nivelin e transparencës, proporcionalitetit, trajtimin të barabartë dhe mos-diskriminimin e Operatorëve Ekonomik (OE), si dhe ankesat e deponuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe vendimet e marra nga ky organ.

Kjo metodologji e hulumtimit dhe monitorimit në prokurimin publik është një nga praktikatat të cilat përdoren gjerësisht nga organizatat mbikëqyrëse dhe kryesisht nga degët e Transparency International, nëpër shtete të ndryshme .

Përparësi kryesore e kësaj metodologjie është fakti se është gjithëpërfshirëse dhe nuk anashkalon asnjë nga fazat e prokurimit. Rëndësi të posaçme i është dhënë bashkëpunimit me operatorët ekonomik, përkatësisht bizneset të cilat janë në marrëdhënie kontraktuale me Autoritetin Qendror të Prokurimit.

Dokumentet të cilat janë përdorur gjatë ekzaminimit të tenderëve kanë qenë: raportet e vlerësimit të tenderëve, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontrata, dosjet e tenderit, ofertat e operatorëve ekonomik, kontratat publike, vendimet e OSHP-së, raportet e ekspertizës, ankesat e operatorëve. Monitorimi aktiv i projektit do të përmirësoj performancën

e përgjithshme të institucioneve me buxhet/rrezik të lartë, si dhe përfshirja e akterëve të ndryshëm në këtë proces do të sjell përfitime për të gjitha palët e përfshira në proces. Pjesëmarrësit nga komuniteti i biznesit (të cilët nuk e kanë fituar tenderin), OJQ-të, gazetarët e mediave kërkimore, anëtarë të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, Autoritetet Kontraktues, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm do të kenë mundësinë të përfitojnë nga njohuritë e KDI të fituara ndër vite.

TRANSPARENCA

Transparenca është sinonim i qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe i ngritjes së besimit tek qytetarët në institucione publike. Transparenca e qasjes në dokumente publike është e drejtë themelore e të gjithë qytetarëve për t'u informuar se si paraja publike është duke u shpenzuar.

Kjo është hera e katërt që KDI bënë monitorimin e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe vlen të potencohet së edhe përkundër zotimeve për bashkëpunim dhe transparencë, qasja në dokumente publike në këtë institucion nuk ka qenë ajo më e lehta. Poashtu, mirëmbajtja e të dhënave dhe organizimi i arkivës është në nivelin shqetësues. Sipas komunikimit me MSH të datës 07 gusht 2015, Divizioni i Prokurimit kishte kërkuar që listës së identifikuar të artikujve të interesit për monitorim t'i shtohet edhe numri i tenderit, meqë ky divizion nuk posedonte me të dhënat se cilët artikuj ishin blerë nën cilën kontratë.

Gjithashtu, mos posedimi i një arkive të caktuar dhe menaxhuar, kishte shkaktuar vonesa në pranimin e dokumenteve relevante nga kjo Ministri. Edhe pse përgjigja pozitive nga MSH ishte pranuar brenda afatit kohor të përcaktuar me Ligjin Nr. 03L-215 Për qasje në dokumente zyrtare, asnjë nga dokumentet e kërkuara nuk ishin pranuar deri më 11 nëntor 2015, pas ankesës së parashtruar nga KDI tek sekretari i përgjithshëm i MSH, kur në KDI u pranuan procesverbalet e hapjes së ofertave.

Ndërmjet muajve gusht 2015 – mars 2016, KDI kishte bërë kërkesën për qasje në 11 kontrata për blerjen e barnave dhe materialit shpenzues, përmes gjithsej pesë kërkesave për qasje në dokumente zyrtare dhe një kërkesë për Informata, mirëpo deri në përpilimin e këtij raporti ishin pranuar vetëm dosjet e kontratave për 6 kontrata. Gjithashtu, meqë një nga ankesat kryesore ishte mungesa e kohës dhe resurseve njerëzore për të

ofruar qasjen e kërkuar, KDI kishte ndarë kërkesat origjinale drejtuar divizionit të Prokurimit, duke parashtruar kërkesa të reja për departamentin e financave lidhur me faturat dhe divizionit të auditimit të brendshëm lidhur me raportet e auditorit të brendshëm për këto kontrata, për të cilat KDI nuk kishte pranuar dokumentet nga MSH.

Poshtu, 2 kërkesa i ishin dërguar AQP për planifikimet e prokurimit për vitet 2012 – 2015, dhe një kërkesë i ishte dërguar OShP për qasje në ankesat dhe vendimet e OShP lidhur me këto prokurime, dhe në të dy rastet kishte pranuar dokumentet e kërkuara brenda afatit një javor.

ANALIZA E KONTRATËS

Duke pasur parasysh buxhetin e limituar krahas kërkesës për përkujdesje mjekësore, sidomos në furnizimin me barna dhe material shpenzues, OBSH ka aplikuar analizën VEN (Vitale, Esenciale dhe të nevojshme) e cila shfrytëzohet për planifikimin e sasive të nevojshme të cilat duhet t'i siguroj MSH si pjesë e kategorisë së parë për të përbushur nevojat e pacientëve. Metodologjia e kësaj analize është fokusimi primar në sigurimin e artikujve vital, nga e cila varet shpëtimi i jetës së njeriut, pastaj sigurimi i artikujve esenciale, që jo medoemos janë të domosdoshme dhe qëllimi është të kuroj apo zgjas jetën por jo intervenim të menjëhershëm shpëtimi, dhe në kategorinë e tretë janë barnat e nevojshme për të cilat në rast se ka buxhet ato mund të sigurohen nga autoriteti përgjegjës por nëse nuk ka buxhet nuk do të shkaktonin probleme jetike për institucionin. Po ashtu një analizë tjetër e aplikuar gjatë planifikimit të buxhetit është ajo e ABC që është një tregues për barnat e shtrenjta dhe ku duhet pasur kujdes që të kursehet buxheti. Do të thotë, sipas OBSH, kategorizimi i barnave dhe materialeve shpenzuese bëhen përmes identifikimit të VEN dhe pastaj në bazë të çmimit dhe vlerës për atë vit.

Në vijim do të paraqesim planifikimet e prokurimeve për tre sektorët e trajtuar në këtë analizë.

Sipas disa analizave të bëra nga Organizata Botërore e Shëndetësisë¹¹ ishte konkluduar se prokurimet e decentralizuara ishin më të adekuate për sektorin e shëndetësisë meqë ato rrisnin fleksibilitetin e furnizimeve më të shpejta, dhe poashtu shiheshin si një mekanizëm për rritjen e llogaridhënies në këtë sektor. Megjithatë decentralizimi i prokurimeve në Kosovë, sidomos ai ndërmjet MSH dhe SHSKUK, kishin rezultuar në zvogëlimin e efektshmërisë së prokurimeve për qendrat shëndetësore, si dhe shumë debate dhe akuza të drejtuara ndaj njëra-tjetrës gjatë fundit të vitit 2015¹².

11 WHO: The World Medicines Situation 2011 - Procurement of Medicines (<http://apps.who.int/medicinedocs/en/m/abstract/Js18769en/>)

12 <http://www.kosova.info/?p=174224>; http://assembly-kosova.org/common/docs/proc/proc_2015_11_25_10_6218_al.pdf; http://www.fsshk.eu/new/index.php?option=com_content&view=category&id=8&layout=blog&Itemid=4

www.fsshk.eu/new/index.php?option=com_content&view=category&id=8&layout=blog&Itemid=4

FURNIZIMI ME CITOSTATIK

VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI

Gjatë vitit 2014 Klinikën Onkologjike e kishin vizituar gjithsej 12,568 pacientë, nga të cilët rreth 800 ishin raste të reja të pacientëve me kancer të gjirit¹³. Si rrjedhojë e këtyre shifrave, njësia menaxhuese kishte parashtruar kërkesën për prokurimin e 790 njësive TRASTUZUMAB 440mg, i cili përdoret për trajtim të pacientëve me HER2-positive për furnizim për një vit. Kjo kërkesë u tenderua me datën 08.01.2015, me numër të Prokurimit 206-15-001-111. TRASTUZUMAB është një barë e patentuar nga Roche, përfaqësues i së cilës për Kosovë është kompania farmaceutike "Meditech" shpk.

Gjatë mbledhjes së grupit punues¹⁵ nuk ka pasur asnjë ankesë lidhur me blerjen e këtij artikulli. Kjo barnë është në Listën Esenciale të Barnave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si një nga barnat më të rëndësishme të nevojshme në një sistem themelor shëndetësor¹⁶.

Sorafemib është një tjetër Citostatik, nga Lista Esenciale që shfrytëzohet parësisht për trajtimin e kancerit në veshkë dhe mëlçi, për trajtim të shkallëve më të avancuara të kancerit tek pacientët. Ky ilaç u aprovua nga Komisioni Evropian në tetor 2007 dhe nga FDA në nëntor 2007 për trajtim të hepatocellular carcinoma

(HCC), që është një nga format më të shpeshta të kancerit në veshkë. Mbretëria e Bashkuar kishte refuzuar aprovimin e këtij ilaçi për shkak të çmimit tejet të lartë të ofruar nga kompania farmaceutike Bayer. Për nevojat e pacientëve, klinika Onkologjike kishte parashtruar kërkesën për 6,120 njësi Sorafemib tbl 200mg, që ishte publikuar me 14.07.2014 me numër të prokurimit 206-14-019-111. Doza e rekomanduar është 2 tableta në ditë, me ç' rast i bie se kjo porosi mbulonte vetëm nevojat e 8 pacientëve për periudhën 365 ditë, edhe pse sipas Listës Esenciale të Barnave të publikuar nga MSH, planifikimi për Sorafemib është 10,800 njësi, që është dyfishi i porosisë së bërë për këtë ilaç. Sipas raportimit të mediave, LEB nuk përmbush as 40% të nevojave të pacientëve¹⁷, dhe edhe pse me një planifikim tejet të ulët krahas nevojave, për shkak të buxhetit të ulët të MSH, ajo nuk arriti të përmbushëj 100% asnjë herë¹⁸.

PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT

Gjatë takimit me grupin punues, por edhe intervistave individuale nuk ka pasur asnjë ankesë lidhur me specifikat e përdorura për prokurimin e TRASTUZUMAB 440mg.

Në propozimin e KEI, Universitetit të Kalifornisë dhe Aleancën e Universiteteve për Barnat Esenciale & Rrjetin e Profesionistëve të rinj për sëmundjet kronike, ata thonë: "Ne konstatojmë, ashtu siç u theksua në mbledhjen e veçantë të Komitetit të ekspertëve në vitin 2002 për HIV / AIDS, se shtimi i barnave të rëndësishme në Listën Esenciale të Barnave të OBSH, e që çmimi i tyre ngjanë i pa përballueshëm, në të vërtetë mund të shërbej si një mekanizëm kyç në zgjerimin e qasjes

13 ASK: Seria 5: Statistikat Shoqërore, Publikimi I Statistikave për Shëndetësinë në 2014

14 <http://koha.net/?id=27&l=66907>

15 KDI Grupi Punues për MSH, I mbajtur me 30 nëntor 2015 në RINGS, Prishtinë

16 http://www.who.int/medicines/publications/essentialmedicines/EML2015_8-May-15.pdf

17 <http://www.kosovalive360.com/lista-esenciale-e-barnave-nuk-permbush-as-40-te-nevojave-te-pacienteve.html>

18 <http://koha.net/?id=27&l=28926>

në këto ilaçe dhe në duke i bërë ata të përballueshme financiarisht¹⁹. Po ashtu, duke iu referuar po të njëjtit projekt propozim, “Bazuar në çmimet e studiara (shprehur në USD), kostoja e trastuzumab nga Roche shkon nga një çmim i ulët prej 3,035.95 \$ për gram në Pakistan në një të lartë prej më shumë se \$ 10,000 për gram në Brazil dhe Oman. Çmimi në Skedarin e Furnizimit Federal në SHBA është 6,266.23 \$ për gram, dhe çmimet në shumicën e vendeve janë në mes të \$ 5,000 dhe \$ 9,000 për gram. Madje edhe në Indi, ku Roche ka implementuar çmime të ulëta duke filluar prodhimin e versioneve të lira të trastuzumab (Herclon, Biceltis), trastuzumab nga Roche është prapë shumë shtrenjtë²⁰.”

Një tjetër argument lidhur me koston e lartë të Trastuzumab, nga po i njëjti projekt propozim, është se gjatë që trastuzumab do të përdoret gjerësisht, sidomos në vendet në zhvillim, pavarësisht nga përfitimet e saj mjekësore, do të jenë shumë të pakta përveç nëse prezantohen versione me kosto të ulët²¹.

Në bazë të citateve të sipërcekura, nga vet parashtruesit e kërkesës për futjen e Trastuzumab në listën Esenciale të Barnave të OBSH, dhe duke pasur parasysh buxhetin tejte të ulët të Kosovës, të alokuar për blerjen e barnave dhe materialeve shpenzuese, shtrohet pyetja nëse ky është investimi më i duhur nga MSH, apo ndoshta do të mund të shfrytëzoheshin alternativa më të lira, të cilat do të mund të mbështesnin numër më të madh të pacientëve në nevojë?

19 Proposal for the inclusion of trastuzumab in the who model list of essential medicines for the treatment of her2-positive breast cancer, KEI, University of California San Francisco, Universities Allied for Essential Medicines (JAEM) & Young Professionals Chronic Disease Network (YP-CDN), Jan 2013, fq. 3

20 Proposal for the inclusion of trastuzumab in the who model list of essential medicines for the treatment of her2-positive breast cancer, KEI, University of California San Francisco, Universities Allied for Essential Medicines (JAEM) & Young Professionals Chronic Disease Network (YP-CDN), Jan 2013, fq. 15

21 Proposal for the inclusion of trastuzumab in the who model list of essential medicines for the treatment of her2-positive breast cancer, KEI, University of California San Francisco, Universities Allied for Essential Medicines (JAEM) & Young Professionals Chronic Disease Network (YP-CDN), Jan 2013, fq. 16

Sa i përket Citostatikut të dytë Sorafemib, me prodhues Bayer, që është pjesë e kësaj analize, ankesat e dala nga grupi punues janë lidhur me mos konsiderimin nga MSH të Sunitinib (Sutent), i prodhuar Pfizer, nga i cili sipas grupit punues ofron jetëgjatësi më të lartë se Sorafenib. Shoqëria Amerikane e Onkologjisë Klinike me një hulumtim të bërë rreth mbijetesës së përgjithshme tek pacientët e trajtuar me Sorafemib dhe ata me Sunitinib, kishin konkluduar se “mbijetesës së përgjithshme me sunitinib nuk ishte superior ose ekuivalente, por ishte dukshëm më inferior për tek sorafenib. Mbijetesja e përgjithshme ishte e krahasueshme në pacientët aziatike dhe të infektuarit më hepatit B. Mbijetesja e përgjithshme ishte superiore në pacientët e infektuar me hepatit C, cilët kishin marrë sorafenib. Tek pacientët e trajtuar me Sunitinib ishin raportuar toksicitete më të shpeshta dhe të rënda²².”

Kërkesat minimale kualifikuese ishin ato për përshtatshmërinë profesionale, kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si dhe sigurimi i tenderit në shumë prej 3% të vlerës së ofertës, por jo më pak se 1,000.00 EURO. Një tjetër kërkesë ishte që para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i suksesshëm duhej të dorëzonte sigurinë e ekzekutimit në shumë prej 10% të vlerës së kontratës.

VLERËSIMI I OFERTAVE

Trastuzumab është një produkt i patentuar nga Roche, përfaqësues i të cilës për Kosovë është “Meditech” shpk., prandaj në përgjigje të njoftimit për kontratë është pranuar vetëm një ofertë, nga kompania e sipërcekur. Oferta e “Meditech” ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga Dosja e Tenderit, siç është dokumentuar edhe në Raportin e Vlerësimit të Ofertave, i datës 10.02.2015. Ajo që është shqetësuese është mos përdorimi i dispozitave ligjore në lidhje me dhënien

22 <http://jco.ascopubs.org/content/early/2013/09/27/JCO.2012.45.8372.abstract>

TAB. 2 – PASQYRIMI I OFERTAVE FINANCIARE

Kompania	Përshkrimi	Sasia	Valuta	Çmimi për njësi	Vlera Totale e Ofertës
Santefarm	Sorafemib 200mg	6,120	EURO	35.49	217,198.80
Asgeto	Sorafemib 200mg	6,120	EURO	42.66	261,079.20
Dallimi			EURO	7.17	43,880.40

e kontratave. Sipas Ligjit Nr. 04/L-042, Neni 35, Pika 2. “Autoriteti kontraktues mund të përdor procedurën të negociuar pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e: 2.1. çfarëdo kontrate publike: (i) nëse, për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet të ipet një operatori të caktuar ekonomik”. Duke marrë parasysh se ky produkt është i patentuar, MSH është dashur të shfrytëzojë këtë dispozitë ligjore, e cila do të përshpejtonte procedurat e prokurimit, si dhe nuk do të paraqiste nevojën për revokim të Nenit 32.5 për dhënien e kontratës 206-15-001-111.

Për të vlerësuar arsyeshmërinë e çmimit të paguar nga MSH në vlerë prej 1,470.00€ për njësi, KDI ka bërë një hulumtim të tregut përmes mekanizmave elektronik, me ç’ rast është vërejtur se çmimi me shumicë është midis 1,800.00 USD dhe 1,955.00 USD për dozë²³.

Për sa i përket njoftimit për kontratë 206-14-019-111, MSH kishte pranuar gjithsej 6 oferta, respektivisht 2 oferta për Llotin 5, furnizim me Sorafemib tbl 200mg. Kompanitë që kishin ofertuar ishin ASGETO, Prishtinë, me ofertën për llotin 5 në vlerë totale prej 261,079.20€

23 http://erc.msh.org/dmpguide/resultsdetail.cfm?language=en-glish&code=TRS440I&s_year=2014&year=2014&str=440%20mg&desc=Trastuzumab&pack=new&frm=VIAL&rte=INJ&class_code2=08%2E2%2E&supplement=&class_name=%2808%2E2%2E%29Cytotoxic%20and%20adjuvant%20medicines%3Cbr%3E

dhe SANTEFARM, Prishtinë, me ofertën në vlerë totale prej 217,198.80€. Oferta e Asgeto nuk përmbante sigurinë e tenderit të kërkuar sipas dosjes së tenderit, dhe për këtë ishte vlerësuar si i papërgjegjshëm, dhe kontrata ishte dhënë Santefarm, të cilit edhe ishin OE me ofertën më të lirë, për furnizimin me 6,120 njësi Sorafemib 200mg, me çmim prej 35.49€ për njësi dhe vlerë totale të kontratës për Llotin 5 prej 217,198.80€. Nëse bëjmë një krahasim ndërmjet dy ofertave të pranuar, shohim se dallimi ndërmjet çmimeve është rreth 20%, që është brenda normave të konkurrencës së tregut.

ANKESAT NË OSHP

Sa i përket Kontratave 206-15-001-111 Lloti 11 furnizim me Trastuzumab, dhe 206-14-019-111 Lloti 5 furnizim me Sorafemib, nuk ka pasur asnjë ankesë nga Operatorët Ekonomik të deponuar në OShP lidhur me fazën e tenderimit dhe vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES

Një nga ankesat më të mëdha në publik është lidhur me furnizimet me material shpenzues, sidomos lidhur me kualitetin e tyre. Brengat kryesore të shfaqura gjatë takimit të grupit punues ishin paqartësi në LEB si dhe në specifikat teknike të produkteve, meqë ato ishin të mangëta dhe nuk i adresonin të gjitha kriteret e nevojshme të një produkti për furnizim. KDI kishte

parashtruar kërkesën për qasje në dokumente publike për kontratat për furnizim me material shpenzues si në vijim: 206-15-025-111, 206-14-088-111, 206-15-015-111, 206-14-022-111, dhe i janë ofruar dokumentet për të gjitha kontratat përveç 206-15-015-111, që kishte për synim të analizonte furnizimet me dorëza sterile kirurgjike.

VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI

Tabela në vijim na pasqyron sasinë e planifikuara për vit, për materialet shpenzuese në fjalë, sipas LEB, si dhe çmimet referente të KRPP për këto produkte:

TAB. 3 – SASITË E PLANIFIKUARA SIPAS LEB DHE ÇMIMET REFERENTE SIPAS KRPP

PËRSHKRIMI	FORMATI / SPECIFIKAT	VEN	Njesi për vit	Vlera e parashikuar	KRPP: Çmimi referent për njësi
GAUZE ABSORBENT COTTON, ROLL, 90 cm x 100 m, jo me pak se 13 fije	te peshoje nga 2.4 deri ne 3kg	V	17,200	335,400.00	20.33 €
GLOVES EXAMINATION	Large	V	2,263,820	72,442.24	0.79 €
GLOVES EXAMINATION	Medium	V	2,877,624	94,961.59	0.79 €
GLOVES EXAMINATION	Small	V	987,650	29,629.50	0.79 €
GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE	Large	V	67,105	97,302.25	1.80 €
GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE	Medium	V	70,355	102,014.75	1.80 €

PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT

Gjatë takimit të grupit punues, brengat kryesore lidhur me furnizimet e sipër cekur ishin se tek artikujt e kontratës së parë për furnizim me Cotton Roll, ceket pesha e pakos, mirëpo në LEB nuk cekët se sa gram duhet të përmbajë pambuku, gjë që bënë kompanitë furnizuese të kenë paqartësi në përcaktimin e saktë të produktit.

Tek artikujt e kontratës së dytë furnizim me dorëza ekzaminuese, nuk cekët nëse këto dorëza kërkohen me pluhur apo pa pluhur. Sipas operatorëve ekonomik, dorëzat me pluhur sot përdorën shumë pak në botë për shkak se janë më pak të shëndetshme, mirëpo tek ne anashkalohet ky fakt për shkak të çmimit më të lirë.

Ndërsa tek kontrata e tretë për furnizim me mantela steril një përdorimësh, nuk ceket nëse këta mantela kanë për qëllim shfrytëzimin gjatë vizitave apo ndërhyrjeve kirurgjike, meqë ato për ndërhyrje kirurgjike janë mantela 4 shtresorë, por që nuk janë të cekura në LEB.

1 KONTRATA MSH 206-15-025-111, LLOTI 4 – FURNIZIM ME GAUZE ABSORBENT COTTON, ROLL, 90 CM X 100 M, JO ME PAK SE 13 FIJE, TE PESHOJE NGA 2.4 DERI NE 3KG

Tenderi 206-15-025-111 ishte ndarë në 10 Lote, ku pikë e interesit për këtë analizë është lloti 4– furnizim me gauze absorbent cotton roll, 90 cm x 100 m, jo me pak se 13 fije.

Përgatitja e specifikave për produktin në fjalë ishte bërë konform LEB. Kërkesat minimale kualifikuese ishin ato për përshtatshmërinë profesionale, kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Një tjetër kërkesë ishte që

para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i suksesshëm duhej të dorëzonte sigurinë e ekzekutimit në shumë prej 10 % e vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 3 muaj ose 90 ditë.

Si evidencë e përshtatshmërisë profesionale OE-të ishin kërkuar të dëshmonin me dokumentacionin si në vijim:

- **EVIDENCA 1:** *Kopje e certifikatës së biznesit;*
- **EVIDENCA 2:** *Kopje e Certifikates se regjistrimit ne vendin e origjinës (për ndërkombëtares);*
- **EVIDENCA 3:** *Kopje e Certifikates se Numrit Fiskal*
- **EVIDENCA 4:** *Kopje e Certifikatës se TVSH-se (për kompanitë vendore)*

Si evidencë e mundësive teknike dhe profesionale, OE-të ishin kërkuar të dëshmonin me dokumentacionin si në vijim:

- **EVIDENCA 1:** *Autorizim nga Prodhuesi - i nënshkruar dhe vulosur (me te dhëna detaje te prodhuesit: adresa, numri i telefonit, emaili etj, ne mënyre qe Autoriteti Kontraktues te ketë mundësi për verifikimit)*
- **EVIDENCA 2:** *ISO 13485; 9001*
- **EVIDENCA 3:** *CE evropiane*
- **EVIDENCA 4:** *Dëshmi qe materiali është i prodhuar apo regjistruar ne se paku një vend te Schengen-it, Britani e madhe, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Izrael, Australi, Zelandë e Re, Turqi (te prodhuara e Turqi).*
- **EVIDENCA 5:** *Licence si qarkullues me shumice për pajisjet medicinale;*
- **EVIDENCA 6:** *Minimumi 1 Referenca ose kontrata për furnizime të ngjajshme, brenda 3 viteve te fundit (2012, 2013, 2014);*
- **EVIDENCA 7:** *Katalogu ose broshura nga prodhuesi për artikujt e ofertuar, ku për te gjithë artikujt dimensionet te jenë te specifikuar qartë dhe te nënvizuar loti dhe i cekur me numër;*
- **EVIDENCA 8:** *Mostra për te gjithë artikujt e ofertuar te jene te evidentuara me numër te lotit dhe te ndara sipas loteve - OBLIGATIVE,*
- **EVIDENCA 9:** *Deklarate nga Kompanitë ndërkombëtare ku deklarohen se do ti regjistrojnë përfaqësitë*



e tyre pranë MTI (Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë) menjëherë pas dhënies së kontratës, dhe para nënshkrimit të kontratës;

- **EVIDENCA 3:** Kopje e Certificates se Numrit Fiskal
- **EVIDENCA 4:** Kopje e Certifikatës së TVSH-se (për kompanitë vendore)

Në rast se operatori ekonomik është grup i operatorëve ekonomik, një draft kontratë duhet ta përcaktojë udhëheqësin grupit, të autorizoi udhëheqësin e grupit që të nënshkruaj komplet tenderin, kontratën dhe dokumentet tjera relevante dhe të përcakton detyrat dhe përgjegjësit të ndarë brenda grupit.

Si evidencë e mundësive teknike dhe profesionale, OE-të ishin kërkuar të dëshmonin me dokumentacionin si në vijim:

- Për pajisjet sterile - dokument shtese:
 - Certifikata/Deklarata e sterilitetit nga Autoriteti Kompetent
- Për produktet e gjakut dhe vaksina – dokument shtese:
 - Official Batch Release Certificate
- Për produkte me origjinë njerëzore dhe shtazore – dokument shtese:
 - Certificate of Suitability for TSE

- **EVIDENCA 1:** Autorizim nga Prodhuesi - i nënshkruar dhe vulosur (me të dhëna detaje të prodhuesit: adresa, numri i telefonit, emaili etj, në mënyre që Autoriteti Kontraktues të ketë mundësi për verifikimit)
- **EVIDENCA 2:** ISO 13485; 9001
- **EVIDENCA 3:** CE evropiane
- **EVIDENCA 4:** Dëshmi që materiali është i prodhuar apo regjistruar në se paku një vend të Schengen-it, Britani e madhe, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Izrael, Australi, Zelandë e Re, Turqi (të prodhuara e Turqij).
 - Për pajisjet sterile - dokument shtese:
 - Certifikata/Deklarata e sterilitetit nga Autoriteti Kompetent

2 KONTRATA MSH 206-14-088-111 – LLOTET 98, 99, 100 FURNIZIM ME GLOVES EXAMINATION, L, M, S

Tenderi 206-14-088-111 ishte ndarë në 146 Lloje , ku pikë e interesit për këtë analizë janë llotet 98, 99, 100 për furnizim me GLOVES EXAMINATION, L, M, S.

Përgatitja e specifikave për produktin në fjalë ishte bërë konform LEB. Kërkesat minimale kualifikuese ishin ato për përshtatshmërinë profesionale, kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Sikurse edhe në kontratën paraprake, si evidencë e përshtatshmërisë profesionale OE-të ishin kërkuar të dëshmonin me dokumentacionin si në vijim:

- **EVIDENCA 1:** Kopje e certifikatës së biznesit;
- **EVIDENCA 2:** Kopje e Certifikates së regjistrimit në vendin e origjinës (për ndërkombëtare);

3 KONTRATA MSH 206-14-022-111 - LLOTET 13 DHE 14 FURNIZIM ME GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L, M.

Tenderi 206-14-088-111 ishte ndarë në 60 Lloje , ku pikë e interesit për këtë analizë janë llotet 13 dhe 14 për furnizim me GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L, M.

Përgatitja e specifikave për produktin në fjalë ishte bërë konform LEB. Kërkesat minimale kualifikuese ishin ato për përshtatshmërinë profesionale, kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si dhe sigurimi i tenderit në shumë prej 3% të vlerës së ofertës, por jo më pak se 1,000.00 EURO. Një tjetër kërkesë ishte që para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i suksesshëm duhej të dorëzonte sigurinë e ekzekutimit në shumë prej 10 % e vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj.



Sikurse edhe në kontratën paraprahe, si evidencë e përshtatshmërisë profesionale OE-të ish-in kërkuar të dëshmonin me dokumentacionin si në vijim:

- **EVIDENCA 1:** *Kopje e certifikatës së biznesit;*
- **EVIDENCA 2:** *Kopje e Certifikates se regjistrimit ne vendin e origjinës (për ndërkombëtares);*
- **EVIDENCA 3:** *Kopje e Certifikates se Numrit Fiskal*
- **EVIDENCA 4:** *Kopje e Certifikatës se TVSH-se (për kompanitë vendore)*

Si evidencë e mundësive teknike dhe profesionale, OE-të ish-in kërkuar të dëshmonin me dokumentacionin si në vijim:

- **EVIDENCA 1:** *Autorizim nga Prodhuesi - i nënshkruar dhe vulosur (me te dhëna detaje te prodhuesit: adresa, numri i telefonit, emaili etj, ne mënyre qe Autoriteti Kontraktues te ketë mundësi për verifikimit)*
- **EVIDENCA 2:** *ISO 13485; 9001*
- **EVIDENCA 3:** *CE evropiane*
- **EVIDENCA 4:** *Dëshmi qe materiali është i prodhuar apo regjistruar ne se paku një vend te Schengen-it, Britani e madhe, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Izrael, Australi, Zelandë e Re, Turqi (te prodhuara e Turqi).*
 - *Për pajisjet sterile - dokument shtese:*
 - *Certifikata/Deklarata e sterilitetit nga Autoriteti Kompetent*

VLERËSIMI I OFERTAVE

1 KONTRATA MSH 206-15-025-111, LLOTI 4– FURNIZIM ME GAUZE ABSORBENT COTTON ,ROLL, 90 CM X 100 M, JO ME PAK SE 13 FIJE, TE PESHOJE NGA 2.4 DERI NE 3KG

Në përgjigje të tenderit 206-15-025-111 Lloti 4 ish-in pranuar gjithsej 3 oferta, me ç' rast dy nga tri ofertat e pranuar kishin plotësuar të gjitha kushtet kualifikuese dhe ish-in vlerësuar si të përgjegjshme, duke mundësuar dhënien e kësaj kontrate në kriterin tenderues të ofertës me çmimin më të ulët, pa revokim të Nenit 32.5 të LPP Nr. 04/L-042. Oferta e Made-kos, që ishte më e lira për këtë llot, nuk kishte plotësuar kushtet teknike, respektivisht dorëzimin e mostrës së produktit. Fitues ishte shpallur Triomed. Tabela në vijim pasqyron ofertat e pranuar për këtë produkt:

TAB. 4 – PASQYRIMI I OFERTAVE FINANCIARE PËR 206-15-025-111

Kompania	Përshkrimi	Sasia	Valuta	Çmimi për njësi	Vlera Totale e Ofertës
Triomed	GAUZE ABSORBENT COTTON ,ROLL, 90 cm x 100 m, jo me pak se 13 fije	5,300	EURO	11.55	61,215.00
Kom-med	GAUZE ABSORBENT COTTON ,ROLL, 90 cm x 100 m, jo me pak se 13 fije	5,300	EURO	13.80	73,140.00
Made-kos	GAUZE ABSORBENT COTTON ,ROLL, 90 cm x 100 m, jo me pak se 13 fije	5,300	EURO	11.30	59,890.00

**2 KONTRATA MSH 206-14-088-111
– LLOTET 98, 99, 100 FURNIZIM ME
GLOVES EXAMINATION, L, M, S**

Blossom por te Mexpo;

- Oferta e Jona Med për llotet 98, 99, 100, nuk kishte plotësuar kriterin e ofrimit të mostrave për artikujt e ofertuar.

Në përgjigje të tenderit 206-14-088-111 Llotet 98, 99 dhe 100 ishin pranuar gjithsej 9 oferta, me ç’ rast tri oferta të pranuar kishin ishin vlerësuar si të papërgjegjshme për arsyet e cekura më poshtë:

- Oferta e Exclusiv Pharma, nuk kishte plotësuar kriterin e minimumi 2 Referenca ose kontrata për furnizime të ngjashme ne institucione, brenda 3 viteve te fundit (2011, 2012, 2013);
- Oferta e Made Kos për llotet 98, 99, 100, kishte ofertuar me prodhuesin Mexpo , ndërsa mostrat e prezentuara ishin të prodhuesit Blossom, ku kishte mospërputhje, meqenëse ISO dhe CE nuk ishin të

Kjo kontratë i ishte dhënë kompanisë AGANI si ofertuesi me çmimin më të lirë.

Pesë nga gjashtë kompanitë e vlerësuara si të suksesshme kishin ofruar çmime konkurruese me një dallim ndërmjet 7 deri në 15% në krahasim me ofertën më të lirë, ndërsa oferta e Liri Med kishte çmime jo konkurruese të cilat ishin rreth 44% më të larta e oferta më e lirë dhe 36% më të larta se oferta e klasifikuar si e 5-ta me radhë për nga çmimi i ofertës.

Tabela në vijim pasqyron ofertat e pranuar për këtë produkt:

TAB. 5 – PASQYRIMI I OFERTAVE FINANCIARE PËR 206-14-088-111

Kompania	Përshkrimi	Lloti	Sasia	Valuta	Çmimi për njësi	Vlera Totale e Ofertës
AGANI Ltd	GLOVES EXAMINATION, L	98	2,509,700	EURO	0.0279 €	70,020.63 €
	GLOVES EXAMINATION, M	99	2,611,400	EURO	0.0279 €	72,858.06 €
	GLOVES EXAMINATION, S	100	1,233,800	EURO	0.0279 €	34,423.02 €
TRIOMED	GLOVES EXAMINATION, L	98	2,509,700	EURO	0.0300 €	75,291.00 €
	GLOVES EXAMINATION, M	99	2,611,400	EURO	0.0300 €	78,342.00 €
	GLOVES EXAMINATION, S	100	1,233,800	EURO	0.0300 €	37,014.00 €
KOMED	GLOVES EXAMINATION, L	98	2,509,700	EURO	0.0317 €	79,557.49 €
	GLOVES EXAMINATION, M	99	2,611,400	EURO	0.0317 €	82,781.38 €
	GLOVES EXAMINATION, S	100	1,233,800	EURO	0.0319 €	39,358.22 €
MEDICAL GROUP	GLOVES EXAMINATION, L	98	2,509,700	EURO	0.0320 €	80,310.40 €
	GLOVES EXAMINATION, M	99	2,611,400	EURO	0.0320 €	83,564.80 €
	GLOVES EXAMINATION, S	100	1,233,800	EURO	0.0320 €	39,481.60 €
REDONI -HM	GLOVES EXAMINATION, L	98	2,509,700	EURO	0.0330 €	82,820.10 €
	GLOVES EXAMINATION, M	99	2,611,400	EURO	0.0330 €	86,176.20 €
	GLOVES EXAMINATION, S	100	1,233,800	EURO	0.0350 €	43,183.00 €
LIRI MED	GLOVES EXAMINATION, L	98	2,509,700	EURO	0.0500 €	125,485.00 €
	GLOVES EXAMINATION, M	99	2,611,400	EURO	0.0500 €	130,570.00 €
	GLOVES EXAMINATION, S	100	1,233,800	EURO	0.0500 €	61,690.00 €

**3 KONTRATA MSH 206-14-022-111
- LLOTET 13 DHE 14 FURNIZIM ME
GOWN SURGICAL STERILE
DISPOSABLE, L, M.**

Në përgjigje të tenderit 206-14-022-111 Llotet 13 dhe 14 ishin pranuar gjithsej 13 oferta, me ç’ rast shtatë nga oferta të pranuar kishin ishin vlerësuar si të papërgjegjshme për arsyet e cekura më poshtë:

- Oferta e Atom Med nuk kishte plotësuar kriterin e ofrimit të mostrave për artikujt e ofertuar;
- Oferta e Exclusive Pharma nuk kishte plotësuar kriterin e ofrimit të mostrave për artikujt e ofertuar;
- Oferta e Friends nuk kishte autorizimin nga prodhuesi “Johnsons & Friends”;
- Oferta e Koslabor nuk kishte cekur vendin e origjinës;
- Oferta e Made Kos nuk kishte autorizim nga prodhuesi Zarys dhe mungonte CE Certifikata;
- Oferta e Medical Group nuk kishte referencat siç ishte kërkuar në Dosjen e Tenderit;
- Oferta e Proxor Trade nuk ishte p’r prodhime të ndonjërit nga vendet e kërkuara sipas dosjes së tenderit;

Tabela 6 pasqyron të gjitha ofertat e pranuar për këtë produkt

Fillimisht, me 22.08.2014 Ministria e Shëndetësisë kishte publikuar njoftimin për dhënie të kontratës kompanisë ofertuese Komed si ofertuesi më i lirë i përgjegjshëm. Pas ankesës së deponuar në OShP nga OE “Friends” të datës 05.08.2015 (për më shumë shih Ankesat në OShP), dhe vendimin e OShP të datës 08.09.2014 me numër të protokollit 283/14, me datën 16.10.2014 MSH kishte publikuar njoftimin për anulimin e kontratës me Komed dhe me datën 14.11.2014 kishte lidhur një kontratë publike kornizë për 24 muaj me kompaninë “Friends”.

ANKESAT NË OSHP

**1 KONTRATA MSH 206-15-025-111,
LLOTI 4– FURNIZIM ME GAUZE
ABSORBENT COTTON ,ROLL, 90 CM X
100 M, JO ME PAK SE 13 FIJE, TE
PESHOJE NGA 2.4 DERI NE 3KG**

Sa i përket Kontratave 206-15-025-111 Lloti 4 furnizim me GAUZE ABSORBENT COTTON ,ROLL, 90 CM X 100 M, nuk ka pasur asnjë ankesë nga Operatorët Ekonomik të deponuar në OShP lidhur me fazën e tenderimit dhe vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

**2 KONTRATA MSH 206-14-088-111
– LLOTET 98, 99, 100 FURNIZIM ME
GLOVES EXAMINATION, L, M, S**

Sa i përket Kontratave 206-14-088-111 Llotet 98, 99, 100 furnizim me GLOVES EXAMINATION, L, M, S, nuk ka pasur asnjë ankesë nga Operatorët Ekonomik të deponuar në OShP lidhur me fazën e tenderimit dhe vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

**3 KONTRATA MSH 206-14-022-111
- LLOTET 13 DHE 14 FURNIZIM ME
GOWN SURGICAL STERILE
DISPOSABLE, L, M.**

Me datën 06.08.2014, kompania “Friends” kishte deponuar një ankesë në OShP lidhur me shpalljen e ofertës si të pa përgjegjshme për furnizimet me material shpenzues nga Lista Esenciale për llotet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46. Në bazë të kësaj ankese të deponuar, OShP, me datën 06.08.2014 kishte lëshuar vendimin

TAB. 6 – PASQYRIMI I OFERTAVE FINANCIARE PËR 206-14-022-111

Kompania	Përshkrimi	Lloti	Sasia	Valuta	Çmimi për njësi	Vlera Totale e Ofertës
FRIENDS*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	0.5690 €	35,437.32 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	0.5690 €	38,236.80 €
MADE KOS*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	0.9500 €	59,166.00 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	0.9500 €	63,840.00 €
KOMED	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	0.9900 €	61,657.20 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	0.9900 €	66,528.00 €
ATOM MED*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	1.1200 €	69,753.60 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.1200 €	75,264.00 €
MEDICAL GROUP*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	2.1900 €	136,393.20 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.9900 €	133,728.00 €
DRIAR	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	1.2500 €	77,850.00 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.2500 €	84,000.00 €
TRIOMED	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	1.3500 €	84,078.00 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.3500 €	90,720.00 €
EXCLUSIVE PHARMA*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	1.2710 €	79,157.88 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.2270 €	82,454.40 €
AGANI	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	1.1900 €	74,113.20 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.1900 €	79,968.00 €
PROXOR TRADE*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	0.7300 €	45,462.40 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	0.7300 €	49,056.00 €
MEDICA	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	1.0900 €	67,885.20 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	1.0900 €	73,248.00 €
IQ MEDICAL	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	0.9900 €	61,657.20 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	0.9900 €	66,528.00 €
KOSLABOR*	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, L	13	62,280	EURO	2.2000 €	137,016.00 €
	GOWN SURGICAL STERILE DISPOSABLE, M	14	67,200	EURO	2.0000 €	134,400.00 €

*Kompanitë e vlerësuara si të papërgjegjshme.



për pezullimin e aktivitetit në fjalë. Pas analizës së ekspertit, ishte konkluduar se diskualifikimi i kompanisë Friends për mungesë të autorizimit për llotet në fjalë ishte i pa bazë dhe OShP me datën 08.09.2014 kishte lëshuar vendimin për anulimin e dhënies së kontratës KOMED dhe që lënda të kthehet në rivlerësim, si rrjedhojë e mos respektimit të Nenit 6 dhe 59 të LPP. Me datën 25.09.2014 OShP kishte lëshuar një Urdhëresë drejtuar AK për respektimin e vendimit të OShP, meqë AK nuk kishte ndërmarrë asnjë aktivitet brenda afatit 10 ditore siç kërkohet me ligj. Po ashtu, si dënim i mos respektimit të vendimit të OShP, AK ishte gjobitur me shumën prej 5,000.00€ dhe zyrtarit të prokurimit i ishte marr certifikata e prokurimit.

FERON ALFA 2a, shiringe e mbushur /sol per inj, 180 mcg, RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg dhe RIBAVIRIN, sol per inj, 1.2g. Qasja në Dosjet e kontratave për furnizim me këto barna ishte kërkuar nga MSH fillimisht me datën 04.08.2015 dhe pastaj me 13.10.2015, mirëpo në KDI ishin pranuar vetëm dokumentet lidhur me furnizimin me RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg, respektivisht kontrata me numër të prokurimit 206-13-050-111.

Ribavirina është një barnë anti-virale që përdoret për infeksione serioze me virus syncytial të kalaneve të frymëmarrjes; infeksionit me hepatitit C, dhe shpesh në kombinim me peginterferon alfa-2b ose peginterferon alfa-2a për rastet rezistuese; si dhe disa infeksione të tjera virale. Sipas LEB ishte parashikuar që në vit të bleheshin 50,000 njësi të RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg, për të përmbushur nevojat e pacientëve.

FURNIZIMI ME BARNA ANTI-VIRALE (ANTI-INFJEKTIVË)

VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI

Sipas të dhënave të Agjencisë Statistike të Kosovës, gjatë vitit 2014 Klinikën e Infektives e kishin vizituar 5,744 pacientë, nga të cilët 3.074 kishin pranuar trajtim spitalor, dhe numri i vdekjeve në këtë klinikë ishte 51²⁴. Një nga problemet kryesore në Kosovë është infektimi i pacientëve të hemodializës me Hepatit B dhe Hepatit C²⁵. Duke u bazuar në këto të dhëna, KDI kishte përzgjedhur monitorimin e prokurimit të barnave PEGINTER-

PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT

RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg, është një barnë gjenerike dhe është lehtë e qasshme në treg. Poashtu edhe përgatitja e specifikave ishte e përgjithshme dhe nuk paraqiste ndonjë kriter favorizues. Kërkesat minimale kualifikuese ishin ato për përshtatshmërinë profesionale, kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si dhe sigurimi i tenderit në shumë prej 3% të vlerës së ofertës, por jo më pak se 1,000.00 EURO. Një tjetër kërkesë ishte që para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i suksesshëm duhej të dorëzonte sigurinë e ekzekutimit në shumë prej 10% të vlerës së kontratës. Poashtu, një kërkesë nga dosja e tenderit ishte që barnat duhet të kishin validitet së paku 12 muaj nga data e liferimit/pranimit në Depon Qendrore të MSH. Ky tender 206-13-050-111 ishte i ndarë në gjithsej 18 Lote, me ç’ rast Lloti 10 ishte i alokuar për blerjen e RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg, për sasinë vjetore 22,180 njësi.

Me datën 14.06.2013 MSH ka njoftuar operatorët

24 ASK: Seria 5: Statistikat Shoqërore, Publikimi I Statistikave për Shëndetësinë në 2014, fq. 40

25 <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2694791/>



ekonomik që kishin tërhequr dosjen e tenderit se ka pasur një ndryshim në Dosjen e Tenderit, ku lloti 11 për furnizim me 3 lloje të insulinës analoge ishte ndarë në tri lloje meqë “paraqet konflikt interesi, sepse prodhuesit tjerë nuk i posedojnë 3 lloje të insulinave të kërkuara”²⁶. Lista e re e barnave të kërkuara përmbante 20 lloje.

VLERËSIMI I OFERTAVE

Në përgjigje të tenderit 206-13-050-111 ishin pranuar gjithsej 13 oferta, nga të cilat vetëm dy oferta ishin për Llotin 10, furnizim me RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg. Të dy ofertat kishin plotësuar të gjitha kushtet kualifikuese dhe ishin vlerësuar si të përgjegjshme, duke mundësuar dhënien e kësaj kontrate në kriterin tenderues të ofertës me çmimin më të ulët. Tabela 7 pasqyron ofertat e pranuar për këtë produkt:

ANKESAT NË OSHP

Sa i përket Kontratave 206-13-050-111 Lloti 10 furnizim me Ribavirin, nuk ka pasur asnjë ankesë nga Operatorët Ekonomik të deponuar në OShP lidhur me fazaën e tenderimit dhe vlerësimin dhe dhënies së kontratës.

26 E-mail nga zyra e prokurimit e MSH tek operatorët ekonomik l dates 6/14/2013 4:02 PM.

TAB. 7 – PASQYRIMI I OFERTAVE FINANCIARE

Kompania	Përshkrimi	Sasia	Valuta	Çmimi për njësi	Vlera Totale e Ofertës
AGANI	RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg	22,180	EURO	2.09	46,356.20
Meditech	RIBAVIRIN, caps/tbl, 200mg	22,180	EURO	2.10	46,578.00
Dallimi			EURO	0.01	221.80

ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE

KDI i kishte parashtruar MSH kërkesën për qasje në raportet financiare, faturat dhe raportet e auditimit lidhur me këto furnizime me datat 04 gusht 2015, 13 tetor 2015 si dhe me 08 shkurt 2016, mirëpo deri me datën 30 mars 2016 nuk kishte pranuar asnjërën nga këto dokumente të kërkuara. Një nga ankesat e Operatorëve Ekonomik që ishin pjesëmarrës në grupin punues të organizuar nga KDI lidhur me monitorimin e këtyre kontratave ishte dallimi tejet i madh ndërmjet sasive të kontraktuara dhe sasive të kërkuara për liferim sipas kushteve të kontratave kornizë, ku kërkohen të kenë në dispozicion një numër të caktuar të artikujve të kontraktuar, por njësitë kërkuese nuk i kërkojnë apo kërkojnë një numër tejet të vogël të tyre. Në mungesë të dokumenteve të sipër cekura, është e pamundur të validohet kjo ankesë nga Operatorët Ekonomik.

REKOMANDIME

- Ofrimi i transparencës në prokurim publik është obligim dhe jo çështje e vullnetit individual. Në këtë drejtim Ministria e Shëndetësisë duhet të ofrojë transparencë të shtuar, lejojë qasje e lirë dhe efikase në dokumentet zyrtare të MSH-së, në përputhje me afatet e parapara në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike;
- Lista Esenciale e Barnave duhet konsideruar si një produkt i gjallë, që duhet rifreskuar dhe pasuruar në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të reflektojë të rejtat e fundit në botën medicinale. Ministria e Shëndetësisë duhet të përkujdeset që LEB të përfshijë specifikacione të azhurnuara të barnave dhe materialeve shpenzuese në mënyrë që këto standarde të plotësohen gjatë blerjes së tyre.
- Ministria e Shëndetësisë të përmirësojë planifikimin e prokurimit, duke krijuar sistem të regjistrimit dhe evidencës elektronike të pacientëve dhe evidencimit të konsumit;
- Ministria e Shëndetësisë të përmirësojë arkivin e prokurimit, dhe të mirëmbajë një bazë të të dhënave për të gjithë artikujt e prokuruar në bazë të kontratave përkatëse;
- Produktet nën patentë, të blihen me procedurën e negociimit të kontratës me prodhuesin me qëllim të sigurimit të çmimit më të volitshëm duke mos paguar për përfitimet e ndërmjetësimit, duke kursyer kohën dhe përshpejtuar procedurat e blerjes dhe liferimit. Blerja përmes distributorëve vendor të realizohet vetëm kur kjo është e pamundur për shkaqe objektive;
- Të krijohet lista e produkteve të cilat janë nën patentë që janë pjesë e listës esenciale të barnave dhe kohëzgjatja e patentës, në mënyrë që kontratat mos të jenë të lidhura për afate më të gjata sesa afati i skadimit të patentimit;
- Duke pasur parasysh ndryshimet e shumta në treg, para hapjes së procedurave të prokurimit, të hulumtohet tregu, për të pasur pasqyrim të përafërt lidhur me ofertën që mund të kenë kompanitë për produkte të caktuara dhe për t'u mbrojtur nga fiksimi i çmimeve.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

615: 658.72(496.51)“2016”

Virusi i transparentitis : monitorimi publik në ministrinë e shëndetësisë : mars 2016 / Instituti Demokratikë i Kosovës.
– Prishtinë : KDI, 2016. – 32 ; 21 cm.

ISBN 978-9951-8927-5-9

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy
Pristina

